**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**SHOQËRIA "ADRIATIKA BETON" SH.P.K.**
**SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**
**Me seli në Shkozet, Ish-N.Sh.N, Shkozet, Durrës**
**NIPT K32227505V**

Nr. Edra Prot. Tiranë, më 24/12/2012

# VENDIM

## I

## MBLEDHJES SË ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME TË ORTAKËVE TË SHOQËRISË "ADRIATIKA BETON" SH.P.K.

Në Durrës, sot më datë 24 Dhjetor 2012(dymijë e dymbëdhjetë), në ambjentet e selisë ligjore të shoqërisë, Ish-N.Sh.N, Shkozet, Durrës, zhvillohet mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme e Ortakëve të Shoqërisë, "ADRIATIKA BETON" Shpk.

Shoqëria "ADRIATIKA BETON" Sh.p.k, është regjistruar si person juridik shqiptar, me Vendim Nr. 29773, datë 30.05.2003, të Gjykatës së Rrethit Tiranë, me NIPT K32227505V dhe seli të saj në adresën: Ish-N.Sh.N, Shkozet, Durrës, Tiranë, Shqipëri.

Shoqëria "ADRIATIKA BETON" Sh.P.K ka një kapital në shumën 155'548'000/0(njëqind e pesëdhjetë e pesëmilion e pesëqind e dyzet e tetëmijë) Lekë dhe është i ndarë në 155'548(njëqind e pesëdhjetë e pesëmijë e pesëqind e dyzet e tetë) kuota, secila me vlerë nominative 1'000(njëmijë)Lekë dhe ortakë të shoqërisë, Z. Ardian Muka që zotëron 30%(tridhjetë përqind) të pjesëve ose 46'664.4(dyzet e gjashtëmijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e katër pikë katër) kuota të kapitalit të shoqërisë dhe "INER" Sh.p.k. që zotëron 70%(shtatëdhjetë përqind) të pjesëve ose 108'883.6(njëqind e tetëmijë e tetëqind e tetëdhjetë e tre pikë gjashtë) kuota të kapitalit të shoqërisë të cilët, të dy së bashku, përbëjnë 100%(njëqind përqind) të kapitalit të shoqërisë "ADRIATIKA BETON" Sh.p.k.

Kjo mbledhje e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve të shoqërisë "ADRIATIKA BETON" Sh.p.k., është thirrur me kërkesën e të gjithë ortakëve të shoqërisë. Verifikohet pjesëmarrja e ortakëve të shoqërisë, nga ku rezulton që marrin pjesë dhe janë të pranishëm, si më poshtë:

1. **ORTAKU : Z. Ardian MUKA,** shtetas shqiptar, lindur më 05.08.1967, në Durrës, Shqipëri, banues në adresën: Lagjja Nr. 6, Rruga "Bashkimi" Nr. 65, Durrës,
2. **ORTAKU : Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "INER",** person juridik shqiptar, i regjistruar me Vendimin Nr.20546, datë 12.01.1999, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, i pajisur me Çertifikatë Regjistrimi, me Numër Identifikimi (NIPT) J91817002H, me seli në adresën: rruga "Perlat Rexhepi" Nd.1. H 14, Ap 7, Njësia Bashkiake Nr. 5, Kodi Postar 1019, Tiranë, Shqipëri, e përfaqësuar nga **Z. Artan DULAKU, Z. Adrian DULAKU** dhe **Genci DULAKU**, të autorizuar me Vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve të shoqërisë "INER" Sh.p.k.,

që do të thotë se janë të pranishëm 100%(njëqind përqind) të pjesëve të kapitalit të shoqërisë "ADRIATIKA BETON" Sh.p.k, gjë që do të thotë se asambleja është thirrur rregullisht, dhe në përputhje të plotë me Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë Tretare" përkatësisht nenit 81, 83 paragrafi 1, 86, e vijues të tij, dhe Statutit të shoqërisë, me praninë e ortakëve, të cilët janë dakord dhe në gjendje për të diskutuar dhe për të vendosur, çështje që kërkojnë një shumicë të kualifikuar, për të diskutuar dhe shqyrtuar mbi;

## PIKAT E RENDIT TË DITËS SI MË POSHTË:

1. Shqyrtimin e raportit "Për Zmadhim kapitali të shoqërisë "ADRIATIKA BETON" Shpk", të hartuar nga Ekspertja Kontabël e Autorizuar e Shoqërisë Zj.Tatiana Filto(Kotepano) me Nr. Liçense 67.
2. Miratimin e zmadhimit të kapitalit të shoqërisë "ADRIATIKA BETON" shpk.
3. Të ndryshme të mundshme.

Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve të shoqërisë "ADRIATIKA BETON" Sh.p.k., pasi shqyrtoi dokumentacionin dhe aktet përkatëse, në zbatim të nenit 81, paragrafi 1, pika "e" dhe "ë" dhe nenit 87, paragrafi 1, e vijues të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", me votën pro, të 100% të totalit të kuotave të kapitalit të shoqërisë, pra me shumicën e kualifikuar të kërkuar nga ligji, në përfundim, në unanimitet të plotë

## V E N D O S I :

1. Të miratojë "Raportin për zmadhim kapitali", të datës 20 Shtator 2012, të hartuar nga studio "Filto Auditing" shpk, me Eksperte Kontabël të Autorizuar Zj. Tatiana Filto(Kotepano) me Nr.Liçense 67, e cila ka evidentuar zmadhimin e kapitalit të shoqërisë "ADRIATIKA BETON" Shpk.

2. Të miratojë zmadhimin e kapitalit të shoqërisë "ADRIATIKA BETON" shpk, nëpërmjet rezervave të krijuara nga fitimet e vitit ushtrimor 2011, për vlerën prej 7'041'000(shtatëmilion e dyzet e njëmijë)Lekë, i ndarë në 7'041(shtatëmijë e dyzet e një) kuota, me vlerë nominale 1'000(njëmijë) Lekë për kuotë.

3. Si rrjedhim i këtij zmadhimi, kapitali i shoqërisë "ADRIATIKA BETON" shpk, bëhet në vlerën totale prej 162'589'000(njëqind e gjashtëdhjetë e dymijë e pesëqind e tetëdhjetë e nëntëmijë) Lekë, të ndarë në 162'589(njëqind e gjashtëdhjetë e dymijë e pesëqind e tetëdhjetë e nëntë) kuota me vlerë nominale 1'000(njëmijë) Lekë për kuotë.

4. Pas përfundimit të temave të rendit të ditës, duke mos patur gjë tjetër për të diskutuar, shoqëria e mësipërme nuk bën ndryshime të tjera, të cilat mbeten ashtu siç janë. Drejtuesi shpall mbylljen e kësaj mbledhjeje të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve të shoqërisë "ADRIATIKA BETON" shpk.

5. Sa më sipër, ky vendim do të depozitohet për regjistrim në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, për t'u pasqyruar kufizimet përkatëse në përputhje me neni, 81 pika "ë", nenit 87, paragrafi 1, e vijues, të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" si dhe nenit 43 e vijues, të Ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit".

**Asambleja e Përgjithshme**
**Shoqëria "ADRIATIKA BETON" Sh.p.k.**
**Ortakët e Shoqërisë**

**"INER"Sh.p.k.**
**Përfaqësuar nga :**
**Përfaqësuesit e autorizuar:**
**Z. Artan DULAKU Z. Adrian DULAKU Z. Genci DULAKU**

**Ardian MUKA**

ADRIATIKA BETON Sh.p.k DURRËS